



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:343643
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06540964

C-IV-14-2657

Paditësi: Sh A nga Gjilani, i cili përfaqësohet avokati Sh Xh nga Gjilani.

Kundër

Të të paditurës: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Prishtinë, rruga “Dritan Hoxha” nr.55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 03.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa për përsëritjen e procedurës.

Arsyetim

Paditësi Sh A nga Gjilani me datë 14.11.2024, ka parashtruar një kërkesë për përsëritjen e procedurës, ndaj aktvendimit të kësaj gjykate që evidentohet me shenjën C-IV-14-2657 me të cilin është konsideruar si e tërhjekur kërkesa për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit të datës; 10.03.2014 që evidentohet me shenjën GJI003-0583/0178 për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore.

Ndaj të këtij aktvendimi është ushtruar fillimisht ankesë në Kolegjin e Apelit të kësaj gjykate të cilën ankesë, kolegji me datën; 27.04.2023 përmes aktvendimit të saj që evidentohet me shenjën AC-I-21-0858-A0001 e kishte refuzuar si të pabazuar

Kërkesa për përsëritjen e procedurës është hedhur poshtë si e papranueshme për faktet si në vijim;

E para kërkesa për përsëritjen e procedurës është dorëzuar në këtë gjykatë e panënshtuar dhe të njëjtës avokati Sh Xh nuk ia bashkëngjitur as autorizimin për përfaqësim që do të thotë se e njëjta është e palejuar.

E dyta gjykata bazuar ne dispozitën e nenit 234 paragrafi 1 e cila dipsozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “ Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, dhe atë: në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë”që do të thotë se është ushtruar pas afatit ligjor

Dhe e treta Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me asnjë dispozitë shprehimore nuk përcakton lejimin e ushtrimit të propozimit për përsëritje e procedurës si dhe të asnjë mjeti të jashtëzakonshëm juridik, andaj edhe bazuar në gjitha të cekurat si më lartë, gjykata ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta e ankesës në afatin kohor prej 15 ditëve, llogaritur nga data e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjyqtari; Asllan Krasniqi